



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
KOMISIONI I AUDITIMIT

Nr. I/41

Datë: 07.03.2024

Në bazë të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 31/15 qershor 2008), duke pasur parasysh Nenin 9 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 13/30 maj 2012), në bazë të Nenit 6 të Rregullores Nr. I/32, të datës 29.02.2024 për Procedurat e Rekrutimit të Pozitave të Zyrtarëve të Lartë të HK-Trainkos Sh.A, Komisioni i Auditimit i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 04, të mbajtur më 07.03.2024 njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Të shpallet konkursi për pozitën:
 1. Zyrtar për Auditim të Brendshëm në HK-Trainkos Sh.A.
- II. Konkursi të jetë i hapur nga data 15.03.2024 deri më datën 15.04.2024.
- III. Obligohet Sekretari që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe të publikojë shpalljen e konkursit sipas kërkesave ligjore.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Komisionit të Auditimit.

Arsyetim

Duke pasur parasysh se pozita e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm aktualisht është duke u mbuluar me Ushtrues të Detyrës, më qëllim të plotësimit të kësaj pozite përmes një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Komisioni i Auditimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për Komisionin e Auditimit

Ruzhdi ZEQRIRI, Kryesues



Iu dërgohet:

- Aksionarit – NJPMNP
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Sekretarit
- Departamentit të Administratës
- Arkivit